LIGJ
Nr.10 486, datë 26.11.2011

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 8662, DATË 18.9.2000 "PËR TRAJTIMIN SI TITULL EKZEKUTIV TË FATURËS SË KONSUMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8662, datë 18.9.2000 "Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike", të ndryshuar, bëhet ndryshimi si më poshtë:

Neni 1

Në titullin e ligjit dhe në nenin 1 të tij, pas fjalës "konsumit" shtohen fjalët "të shitjes, të blerjes dhe faturat e shërbimit të transmetimit dhe shpërndarjes".

Neni 2
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.7183, datë 7.12.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Bamir Topi